



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 66

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË ROSKOVEC, PËR
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 22 Shkurt 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administravtive me:

SUBJEKT: Zj. Delina Hoxha, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për bashkinë Roskovec

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Roskovec, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 28.1.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin 2 (dy) veprimtarive publike të kryera nga bashkia Roskovec, të cilat pretendohet se rezultojnë të paraportuara në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

1. “Të vendosur për të dëgjuar zërin e grave dhe vajzave të lagjes nr. 2 nëpërmjet projektit; “Një kafe aty ku jeton ti”.

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 66

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Roskovec, për raportimin e veprimtarive publike”

Link:<https://www.facebook.com/photo?fbid=562102465960419&set=pcb.562102599293739>

2. "Së bashku me Ministren e Turizmit dhe Mjedisit, zj. Mirela Kumbaro; Shefen e Bashkëpunimit Gjerman për Zhvillim në Shqipëri, zj. Judith Hoffman; Kreun e grupi parlamentar z. Taulant Balla, inaguruam pikën e kompostimit".

Link:<https://www.facebook.com/photo/?fbid=560873546083311&set=pcb.560873956083270>

Veprimtaria publike rezulton të jetë transmetuar në 3 (tre) media publike.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Më datë 16.2.2023, bashkisë Roskovec i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike

Më datë 20.2.2023, ora 10:34 PM, bashkia Roskovec informon ndër të tjera nga se:

"...Si person përgjegjës për raportimin e aktiviteteve jam pajisur me kredencialet në datë 17.1.2022, dhe përgjatë një jave kam pasur veshtirësi në raportimet në faqe. Për sa më sipër gjatë javës së parë pas pajisjes me kredencialet jemi munduar të bëjmë raportimet edhe për aktivitetet të cilat kishin kohë që ishin planifikuar dhe nuk mund të pezulloheshin ose shtyheshin për shkak të angazhimeve të pjesëmarrësve në këto aktivitete...

1. Lidhur me aktivitetin "Së bashku me Ministrën e Turizmit dhe Mjedisit, zj.Mirela Kumbaro; Shefen e Bashkëpunimit Gjerman për Zhvillim në Shqipëri, zj.Judith Hoffman; Kreun e grupi parlamentar z. Taulant Balla, Inaguruam pikën e kompostimit", ju sqarojmë se, ky aktivitet është raportuar në ndërfaqen e KQZ, në datë 19.1.2023 dhe është publikuar në faqen e bashkisë Roskovec në datën 30.1.2023 sipas linkut më poshtë:

https://www.facebook.com/photo/?fbid=566161425554523&set=pcb.566161708887828&locale=sq_AL, linku i dërguar nga ana juaj nuk është i vlefshëm. Bashkëlidhur po ju dërgoj edhe raportimin në ndërfaqe. Ky aktivitet është zhvilluar në datën 20.1.2023, ora 11:30, me pjesëmarrje të zj.Mirela Kumbaro; Shefen e Bashkëpunimit Gjerman për Zhvillim në Shqipëri, zj.Judith Hoffman; Kreun e grupi parlamentar z.Taulant Balla dhe kryetares së bashkisë Roskovec për Inagurimin e fushës së kompostimit të ndërtuar me bashkëfinancim nga projekti GIZ Albania.

2. Lidhur me aktivitetin "Të vendosur për të dëgjuar zërin e grave dhe vajzave të lagjes nr. 2, nëpërmjet projektit; "Një kafe aty ku jeton ti". Kjo është një nismë e ndërmarrë nga kryetarja e bashkisë Roskovec, e cila ka filluar që në muajin Prill të vitit 2022 dhe vijon me mënyrë periodike me gratë e thjeshta të komunitetit të bashkisë Roskovec, për ndërgjegjësimin e tyre dhe gjithëpërfshirjen në jetën publike për të dëgjuar nevojat që ato kanë. Ky projekt ka realizuar disa takime nga muaji Prill 2022 deri më tani.

Ky aktivitet është zhvilluar ditën e shtunë, datë 24.12.2022, dhe pjesëmarrëse në aktivitet ishin gra, banore të bashkisë Roskovec, pa praninë e mediave..."

Pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik.

Pas verifikimeve të bëra në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rezultoi se aktiviteti është raportuar përtej afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, si pasojë e shkakut objektiv të sipërcituar. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ për ato shkelje që lidhen me çështjen objekt shqyrtimi.

Për sa i përket veprimtarisë tjetër publike të kryer nga institucioni i bashkisë Roskovec, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se detyrimi për raportim i veprimtarive publike të institucioneve ka nisur më datë 13.1.2023, dhe kjo veprimtari nuk përbën objekt të detyrimit për raportim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, dhe vendimit nr. 09, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S :

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Delina Hoxha person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Roskovec.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Tërheqje vëmendje ndaj bashkisë Roskovec, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI